



Youth Corner

ULQIN — ULCINJ

“Horizonti i Ri” fillon realizimin e projektit “Këndi për të rinj në Ulqin”

Program për pjesëmarrjen e të rinjve

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është që t’iu sigurojë të rinjve në Ulqin më shumë mundësi për kalimin e dobishëm të kohës së lirë, zhvillimin e kulturës së leximit dhe të dialogut në një hapësirë më të përshtatshme, si dhe promovimin e filantropisë në komunitetin lokal

Ulqin – Organizata e Shoqërisë Civile “Horizonti i Ri” ka njoftuar se fillon realizimin e projektit “Këndi për të rinj në Ulqin”.

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është që t’iu sigurojë të rinjve në Ulqin më shumë mundësi për kalimin e dobishëm të kohës së lirë, zhvillimin e kulturës së leximit dhe të dialogut në një hapësirë më të përshtatshme, si dhe promovimin e filantropisë në komunitetin lokal.

Nga kjo organizatë kanë bërë të ditur se aktivitetet kryesore të projektit do të jenë: trajnimi i edukatorëve bashkëmoshatarë për promovimin e aktivizimit rinor dhe kulturës së bamirësisë (filantropisë), adaptimi i hapësirës në Bibliotekën e Qytetit dhe vënia në

funksion e „Këndit Rinor“, organizimi i aksionit të mbledhjes së mjeteve në komunitet si dhe organizimi i ngjarjeve kreative dhe promovuese.

“Programi për trajnimin e edukatorëve të rinj do të ndiqet nga 20 aktivistë rinorë. Programi përfshin katër seminare në këto tema: komuniteti dhe unë - hulumtimi i rolit personal në komunitet dhe zhvillimi i tij, promovimi i filantropisë në komunitet; komunikimi i suksesshëm - komunikimi në grup, udhëheqja e mbledhjeve, proceset e menaxhimit të vendimmarrjes; aktivizimi dhe vullnetarizmi – në cilat mënyra të rinjtë mund të ushtrojnë pjesëmarrjen aktive, të drejtat dhe detyrimet e vullnetarëve, promovimi i vullnetarizmit; planifikimi dhe shkrimi i projek-

tit - përmirësimi i aftësive të analizës dhe kornizës logjike në parashtrimin e ideve, problemeve, qëllimeve dhe aktiviteteve”, thuhet në deklaratën për shtyp.

Pas përfundimit të këtij cikli edukativ, pjesëmarrësit të cilët me sukses e kanë zotëruar programin e trajnimit do të marrin një çertifikatë që konfirmon se ata janë të kualifikuar për punë edukuese me të rinjtë dhe se ata mund të vazhdojnë trajnimin në mesin e kolegëve në mjedisin e tyre.

Projekti “Këndi për të rinj në Ulqin” mbështetet nga Fondi për Qytetari Vepruese – FAKT, përmes programit “De Facto Active”, të cilin e financon Bashkimi Evropian përmes Delegacionit të BE-së në Mal të Zi. **(Kohapress)**